



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:131057

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05296975

KE.nr. 851/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike të paditësit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, rr. "Ukshin Hoti", Kompleksi "Ramiz Sadiku", kati IX, kundër të paditurës "Beni Dona" Sh.P.K., me numër të biznesit 70238636 dhe seli në Prishtinë, Ulpianë, Tregu i Gjelbër, me objekt kontesti kthimi i mjeteve për shkak të mospërmbushjes së kontratës, vlera e objektit të kontestit EUR 100,000.00, duke vendosur sipas parashtresës së paditësit për tërheqjen e padisë, jashtë seancës, më datë 07.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se është tërhequr padia e evidentuar me numër KE.nr. 851/22, e paditësit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kthimi i mjeteve për shkak të mospërmbushjes së kontratës, kundër të paditurës "Beni Dona" Sh.P.K., me numër të biznesit 70238636 dhe seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Paditësi Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me datën 07.10.2020, pranë kësaj Gjykate, ka paraqitur padi për kthimin e mjeteve financiare për shkak të mospërmbushjes së kontratës, ndaj të paditurës "Beni Dona" Sh.P.K., me të cilën ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadija e paditësit, ndërsa të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kthej në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës shumën prej EUR 100,000.00, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e

paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi.

Me datën 02.11.2020, paditësi me anë të parashtresës, e ka njoftuar Gjykatën se për këtë çështje juridike e tërheqë padinë e parashtruar më datën 07.10.2020, pasi që pala e paditur i ka kthyer mjetet financiare përmes urdhër pagesës nr. ref. 530078844 të ProCredit Bank.

Nga sa më sipër, gjykata duke vepruar sipas parashtresës së paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 851/22, datë 07.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha